



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Interlab sh.p.k** lidhur me Lot-in:1 të aktivitetit të prokurimit me titull: ~~“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë”~~ me Nr. të Prok: 206-24-8799-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Interlab sh.p.k**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë” **Lot: 1** me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 09.10.2024 të publikuar në platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 09.10.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Interlab sh.p.k**, me datën 14.10.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë” Lot 1** me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datën 17.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues Interlab sh.p.k:

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës Neni 11 Informatat Sekrete Afariste
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 72 Kerkese per informacione shtese
- Neni 99 Funksonet dhe Kompetencat e OSHP

Pretendimi ankimore te OE ankues Interlab sh.p.k:

Te nderuar,

Kërkesa për rishqyrtim është ne pajtim me Nenin 108/A te LPP-se, Paragrafi 2 “në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”.

Me datën 09.10.2024 përmes e-prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se duke rekomanduar për kontrate OE MADEKOS SH.P.K.; NPT MEDICA SH.P.K. për LOT 1 të aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” dhe me nr. të prokurimit 206-24-8799-1-1-1. Po me datën 09.10.2024 sipas Nenin 10 Paragrafi 3 te LPP-se kemi kërkuar qasje ne ofertën e konsorciumit MADEKOS SH.P.K.; NPT MEDICA SH.P.K. por me datën 10.10.2024 kemi pranuar email qe pjesërisht dokumentet nga AK-ja me arsyetimin se dokumentet tjera janë konfidenciale për shkak se OE ka plotësuar kërkesën për konfidencialitet qe përfshin dokumentet e ofertës sipas Nenin 68 dhe 69 te LPP-se.

Ne Kerkesen per Konfidencialitet si nga OE Madekos dhe OE Medica jane kerkuar qe nje numer i madh i dokumentave te dorezuar te jene pjese e sekretit afarist, shih me poshte:

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

(më tej “Autoriteti Kontraktues”)

DUKE PASUR PARASYSH SE MADEKOS sh.p.k. (më tej “Operatori Ekonomik”), duke pëmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

Operatori ekonomik Made-Kos, konform ligji Nr.04/L-042 per prokurimin publik te Repablikes se Kosovaes, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L237, Ligjin Nr.05/L068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke i bazuar ne nenin 11 Informatat Sekrete Afariste kerkon qe te gjitha dokumentacioni i Tenderit i cille eshte kerkuar konform nenit 68,69,70 te trajtohet si sekret afarist.

1. Autorizime

2. ISO,CE-Konformitet, Katalog, dhe Lista e kontratave me Referenca.

Aneksi 3 KËRKESE PËR KONFIDENCIALITET

Për: Ministria e Shëndetësisë

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE [MEDICA SHPK] (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, kërkojnë dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Operatori Ekonomik MEDICA, konform Ligji Nr. 04/L-012 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Indryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke i bazuar në Neni 11 Informatat Sekrete Afariste kërkon që të gjithë dokumentacioni i tenderit i cili është i kërkuar konform Neni 68- Gjendja Ekonomike dhe Financiare dhe Neni 69 - Afërsia Teknike dhe/ose Profesionale të trajtohet si sekret afarist!

Siç precizohet në vet emërtimin "Kërkesë për Konfidencialitet" në këtë rast Grupi i OE paraqet te AK për dokumentet që thekson sipas Nenit 68 dhe 69 të LPP-se, por kërkesa në fjale duhet të "APROVOHET" nga AK se pse këto dokumentet klasifikohen si sekret afarist, ndërsa në rastin në fjale në nuk kemi pranuar asnjë vendim apo njoftim se kërkesa e tillë e konsorciumit është aprovuar nga AK-ja me arsyetimin përkatës.

Përmbushja e formës standarde të kërkesës për konfidencialitet nuk është obligative për Autoritetin Kontraktues sepse edhe në rastet kur përmbushen 3 kushtet ligjore të Nenit 11 të LPP-se, Paragrafi 3 Pika 1, 2 dhe 3 përsëri është e drejte AK-se në diskrecion të plote që dokumentet në fjale të klasifikoj apo jo si sekret afarist siç e rregullon Paragrafi 3 të Nenit 11 "Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere".

Operator ekonomik me kërkesën për konfidencialitet ka plotësuar vetëm kushtin ligjor të Neni 11 Paragrafi 3 pika 1 dhe 2, ndërsa nuk ka plotësuar kushtin ligjor të Paragrafi 3 që thotë "kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrihen arsyet, që bindshëm demonstrrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtrimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Dokumentet për sekret afarist nga AK-ja është dashur të ofrohen për Interlab SH.P.K sepse këto dokumentet kanë qenë pjesë të vlerësimit të përzgjedhjes dhe nuk kanë paraqit asnjë rrezik të dëmtrimin të interesave komerciale të grupit të OE. Pjesë të këtyre dokumenteve sipas njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit është: *CE certifikatat dhe Katalogu i prodhuesit që nuk paraqet asnjë rrezik të dëmtrimin komercial të grupit sepse këto dokumente janë të prodhuesit.*

Përmes katalogut të prodhuesit në si ankues mund të konstatojmë se Grupi i OE a i ka plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1 të dosjes së tenderit, ndërsa mos ofrimi i katalogut nuk mundëson në asnjë mënyrë që të vërtetojmë këtë pretendim ankimor.

Autoriteti kontraktues nuk mund te klasifikoj si sekret afarist asnjëherë "Katalogun e Prodhuesit" sipas Neni 11 Paragrafi 3 Pika 1, 2 dhe 3 te LPP-se, sepse nuk është dokument i OE qe ofertojnë por dokumentet i prodhuesit ku mbi bazën e tij gjate vlerësimit konstatohet se a plotëson kërkesat teknike te dosjes se tenderit. Përveç katalogut thuajse asnjë dokumentet tjetër AK-ja nuk duhet te aprovoj si sekret afarist sepse LPP-ja kërkon respektim te Neni 1, 6, 7 dhe 59 te LPP-se gjate një procedure te prokurimit, pra transparence, trajtim te barabarte dhe vlerësim te tenderëve ne pajtim me kërkesat e dosjes se tenderit qe ne ketë rast AK ka shkelur te gjitha këto parime baze te Neneve te LPP-se.

Mungesa e dokumenteve te konsorciumit qe bëjnë pjesë te Neni 68 dhe 69 te LPP-se janë shumica e kriterëve kryesore te përzgjedhjes dhe katalogu qe bene pjese aty ne mënyrë qe te konstatojmë se Grupi i OE i ka plotësuar apo nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit.

Nga qasja e marre, argumentojme pretendimet si ne vijim:

1. Pretendimi Pare Ankimor

Çertifikata Nr.: W-240837-Q te leshuar nga WQR International Certification Ltd (si trup çertifikues) per OE Medica si pjese e grupit te OE te rekomanduar per dhenie te kontrates, eshte i rreme sepse Institucion- World Accreditation Services(trup akreditues).nuk eshte i akredituar per te leshuar nje document te tille.

Per te vertetuar se dokumenti i dorezuar nga OE Medica eshte i rreme ju lutem referojuni Uebsite zyrtare te World Accreditation Services ku pretendon se bene pjese ne IAF, pra trup akredituese nga IAF referuar Uebsite te tyre <http://thewas.us/about-was.php>, por ne realitet "World Accreditation Services" nuk eshte pjese e IAF dhe as e akredituar nga IAF(si trup akreditues) per te ofruar sherbime te tilla apo per te autorizuar kompani tjera.

Se nuk eshte pjese e IAF, vertetohet fare thjeshte duke kerkuar ne linkun si me poshte, qe paraqet listen e trupave akreditues dhe pjesetareve:

<https://iaf.nu/en/accreditation-bodies/>

Ne kete link mund te kerkohen emrat e kompanive qe jane te pajisur me certifikata valide, ndersa World Accreditation Services nuk figuron ne kete databaze dhe nuk eshte e akredituar.

Perveç kesaj ne kemi kontaktuar IAF dhe permes email-es zyrtare kemi pranuar konfirmimin si me poshte:

Betim Sadriu

From: IAF General Enquiries <iaf@iaf.nu>
Sent: Monday, September 25, 2023 9:51 PM
To: Betim Sadriu
Subject: Re: Request for information

Dear Betim Sadriu,

World Accreditation Service (WAS) is not a recognized Accreditation Body member of IAF. A list of IAF recognised ABs is available [here](#).

Regards,

IAF General Enquiries

On Sep 25, 2023, at 10:07 AM, Betim Sadriu <betim@interlab-ks.com> wrote:

Dear IAF staff,

I hope you are doing fine.

I am Betim Sadriu, from Prishtina, Kosovo 10000.

Recently we have encountered in procurement activity some company that offered an ISO 9001 which we suspect this ISO is not issued from an accredited body but might be from a fraudulent certification company.

I am attaching you the ISO 9001 from the company we received, the certification body is from turkey WQRCERT " www.wqrcert.com "
The accreditation body is: WAS – World Accreditation Services.

On the about information about the Wold Accreditation Services they state that they are the member of the IAF but while searching on your website we couldn't find it anywhere.

Can you please inform me if the WAS – World Accreditation Services is a member of the IAF or not ?

With Regards !

Betim Sadriu
CEO

<image001.png> +383(0)44517811
<image002.png> +383(0)45555071
<image003.png> betim@interlab-ks.com
<image004.png> www.interlab-ks.com

<image005.jpg>

World Accreditation Services nuk eshte e akredituar si kompani dhe as te drejte te certifikoj kompani tjera te leshoj ISO 9001:2015 si ne rastin ne fjale sepse nuk eshte e akredituar nga IAF, pra te gjitha certifikatat e leshuara ne logon e WAS si trup akredituese jane jo valide.

Per sqarimin tuaj shtese ne hapin trete mund te kerkoni per Interlab shpk qe shihet se eshte pajisur me certifikate valide ISO 9001:2015 per sherbime nga Certis SH.P.K:

<https://www.iafcertsearch.org/certified-entity/hsFXuBHLYPIQGdP18Xgclib6>

Për artikujt:

Art.85 – Telefon për zyre

Art. 130- Paletar elektrik (Pirunar) - mjet për bartjen e materialit shpenzues. Rekomandim: Duhet të furnizohet me Paletar elektrik (Pirunar) për bartjen e materialit shpenzues

Art.155 – Furnizim me rezervuar 15000-200000 L

Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k” është ARI-KINA, gjë që nuk qëndron, pasi që prodhuesi ARI nuk i posedon këta artikuj në linjën e produkteve.

Vërtetimin mund t'a gjeni në linkun e mëposhtëm dhe produktet që I prodhon ARI:

<https://www.ari-cn.com/list-Product.html>

Për Art. 120. Peshorja Multifunksionale për matjen e peshës së pacientit së bashku me karrocë. Rekomandohet që kapaciteti i matjes të jetë deri në 300-400 kg.

Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k është GIMA S.P.A, nëse shikojmë në katalogun e GIMA S.P.A , peshore për matjen e peshës së pacientit së bashku me karrocë është e kapacitetit deri 200kg dhe nuk e plotëson kriterin prej 300-400kg, gjithashtu GIMA S.P.A është vetëm distributor i këtij produkti dhe prodhuesi në bazë të deklaratës së konformitetit është SOEHNLE.

Pasi që në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k”, është deklaruar si prodhues GIMA S.P.A, ne dyshojmë që O.E nuk e posedon autorizimin e prodhuesit nga kompania SOEHNLE., por vetëm nga distributori GIMA S.P.A, gjë që bien ndesh me kërkesën e AK-së në pikën 9.1 & 9.2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se është i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit. Në rastin e dorëzimit të autorizimit nga përfaqësuesi kërkohet të dëshmohet edhe autorizimi në mes prodhuesit me përfaqësuesin.

Për Art.145 - Barelë për bartjen e pacientëve

Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k është GIMA S.P.A, por pas hulumtimeve që kemi bërë në website kemi vërtetuar që prodhuesi është nga kompania kineze:

Jiangyin Everise Medical Equipment Co.,Ltd 1001 Chengyang Road,Jiangyin City, Jiangsu,China,

,Pra GIMA S.P.A është vetëm distributor i saj.

Në linkun e mëposhtëm e vërtetoni me ISO dhe CE të prodhuesit të ngarkuar në faqen e GIMA S.P.A:

https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=34103&dept_selected=634&dept_id=6342

Pasi që në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k”, është deklaruar si prodhues GIMA S.P.A, ne dyshojmë që O.E nuk e posedon autorizimin e prodhuesit nga kompania kineze, por vetëm nga distributori GIMA S.P.A, gjë që bien ndesh me kërkesën e AK-së në pikën 9.1 & 9.2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se është i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit. Në rastin e dorëzimit të autorizimit nga përfaqësuesi kërkohet të dëshmohet edhe autorizimi në mes prodhuesit me përfaqësuesin.

Shkelje të Renda nga zyrtaret e prokurimit

Autoriteti kontraktues/zyrtaret e prokurimit nuk kanë ofruar dokumentet e grupit të OE që cilat bëjnë pjesë të Nenit 68 dhe 69 të LPP-se me arsyetimin e vetëm se konsorciumi ka plotësuar kërkesën për konfidencialitet, andaj për shkak të kësaj kërkesë nuk mund t'ju ofrojmë dokumentet në fjale. AK-MSH nuk ka ofruar asnjë përgjigje përse i ka aprovuar këto dokumentet si sekret afarist në bazë të kërkesës nga konsorciumi.

Zyrtaret e prokurimit me rastin e mos respektimit të plote të Nenit 11 të LPP-se kanë bërë shkelje të Rregullores për Prokurimi Publik Nr.001/2022 Neni 97 Shkeljet e rënda, Pika c “Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu ankues ne KRPP respektivisht te Departamenti i Monitorimit do kërkoj te bej një hetim ndaj kësaj procedure te prokurimit sepse zyrtaret e prokurimit dyshojmë se me mos ofrimin e këtyre dokumenteve ka bere Shkelje te Rregullores për Prokurimi Publik Nr.001/2022 Neni 97 Shkeljet e rënda Pika c Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Te bashkangjitur keni dëshmitë e-mail e komunikimit.

8. Dëmet materiale

Shpenzimet procedurale per tender!

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Në lidhje me kërkesën për rishqyrtim nga Interlab SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titullin "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë" Numer te prok. 206-24-8799-1-1-1, e datës 14.10.2024, Autoriteti Kontraktues shqyrtoi me kujdes pretendimet dhe konstaton si ne vijim:

Sa i përket pretendimit të pare (1): Ky pretendimi i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, lidhur me certifikatës ISO të dorëzuar nga OE Medica si pjesë e grupit të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk ka asnjë bazë ligjore dhe hidhet poshtë në tërësi për disa arsye:

Sipas Nenit 59 të LPP-së, lidhur me Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të vlerësojë ofertat e dorëzuara vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara në Njoftimit për Kontrate dhe Dosjes së Tenderit. **Certifikatat ISO nuk kanë qenë një kriter i kërkuar në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit.** Prandaj, a është e vlefshme ose jo e certifikatave ISO të dorëzuara nga operatorët ekonomikë "MEDICA sh.p.k", nuk ka asnjë ndikim në rezultatin e vlerësimit të tenderëve.

Gjithashtu, sipas Nenit 7 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Në këtë kontekst, nuk mund të vendosen kriteret shtesë pas përfundimit të periudhës së paraqitjes së ofertave. Çdo pretendim i lidhur me ISO-në si kriter përjashtues bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë, duke qenë se ky nuk ishte një kriter i kërkuar në dosjen e tenderit për asnjë operator ekonomik.

Për këto arsye, pretendimi juaj për vlefshmërinë e certifikatës ISO të OE Medica hidhet poshtë, pasi është jashtë fushës së vlerësimit të ofertave dhe nuk është në përputhje me kërkesat e Njoftimit për Kontrate dhe Dosjes së Tenderit.

Sa i përket pretendimit të pare (2): Në lidhje me pretendimet që keni paraqitur për mospërputhjen e specifikimeve teknike dhe autorizimin e prodhuesve në disa pozicione të tenderit, dëshirojmë të theksojmë se oferta e rekomanduar është kontrolluar nga ekspertë të fushës së Bioinxhinierisë, të cilët kanë për detyrë të sigurojnë përputhshmërinë e ofertave me kërkesat e dosjes së tenderit dhe Specifikat teknike të kërkuara.

Pas shqyrtimit, është vërtetuar se operatori ekonomik në fjalë ka dorëzuar dokumente të plota dhe të sakta, përfshirë autorizimet e kërkuara nga prodhuesit ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre, duke përmbushur kështu kërkesat ligjore të përcaktuara në pikat 9.1 dhe 9.2 të dokumentacionit të tenderit. Kjo siguron që Oferta e OE të rekomanduar është në përputhje me kërkesat teknike dhe profesionale të tenderit.

Sa i përket pretendimit të Tretë (3): Në lidhje me kërkesën tuaj për qasje në dokumente të klasifikuara si sekret afarist, Neni 11 i LPP-së qartëson se Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas Nenin 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët

ekonomikë kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se Aneksi 3 - Kërkesa për Sekret Afarist ka qenë pjesë e ofertës së dorëzuar dhe është respektuar nga Autoriteti Kontraktues. Ky aneks është dorëzuar nga të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë edhe ju si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Prandaj, qasja në dokumentet e klasifikuara si sekrete afariste është refuzuar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë për të gjithë operatorët, duke respektuar kërkesat për konfidencialitetin sipas ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme.

Njëjtë sikur OE i rekomanduar edhe ju ne ofertën e juaj keni ofruar Deklaratën për konfidencialitet:

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

(në tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PATUR PARASYSH SE [Interlab sh.p.k] (në tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:



| |
|---|
| Përshtatshmëria profesionale, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Kapaciteti teknik dhe profesional. |
|---|

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

| |
|---|
| <i>Kërkojmë nga AK që të shkoj përkritazi me nenin 11 të LPP duke e respektuar informatat sekrete afariste të OE, në këtë rast të Interlab shpk. Interlab shpk deklaron se informatat e përmendura (Listën e Kontratave me Referenca, Katallogjet, Autorizimin, CE certifikatat dhe përshkrimin e cmimit) i konsiderojmë si pronë jo publike dhe çdo qasje publike në informatat e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të Interlab shpk.</i> |
|---|

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) | |
|---|---|
| Emri i Kompanisë: | Interlab sh.p.k |
| Adresa e plotë: | Rr. Lidhja e Pejës Nr.75, FushëKosovë 12000 |
| I përfaqësuar nga: | |
| Emri: | Betim Sadriu |
| Pozita: | Drejtor |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 23.09.2024 |
| Vula: |  |

Gjithashtu, vlen të theksohet se në këtë kërkesën për rishqyrtim ju nuk keni ofruar asnjë dëshmi apo kundërshtim për pretendimet ankimore mbi bazën e të cilave oferta juaj është eliminuar, ku janë në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, janë evidentuar mangësi të shumta në ofertën tuaj si ne vijim:

Te Pjesa II, Përshkrimi i Çmimeve, në kolonën Prodhuesi dhe vendi i Origjinës, ju nuk e keni përshkruar fare Emrin e Prodhuesit me të cilin Oferton, por vetëm emrin e shtetit (Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet).

Sipas UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 10, sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit tregon se, në raste të tilla, Tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP-së |
|--|---|---------------------|
| Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |

Bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik **Interlab SH.P.K** dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nenet 9.1 dhe 9.2 të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit**, OE është i obliguar të dorëzojë katalogun (broshurën) e pajisjeve të ofruara, me specifikim të qartë të produkteve dhe specifikave teknike, së bashku me linkun e faqes zyrtare të prodhuesit. Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni ka konstatuar se OE Interlab SH.P.K nuk ka prezantuar në oferte katalogun për pajisjet me numër: **5, 80, 84, 85, 86, 87, 90, 91, 118, 129, 130, dhe 131.**

Mos dorëzimi i këtyre katalogëve nga OE bie në kundërshtim me kërkesat e qarta të tenderit, të cilat përcaktojnë se specifikimet teknike dhe katalogu janë të detyrueshme për mallrat e ofruara. Sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik:

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP-së |
|---|---|---------------|
| Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimet teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene në përputhje me specifikimin e kërkuar) | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 28 |

Për më tepër, sipas **Nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**, mosplotësimi i këtyre kërkesave konsiderohet shkelje thelbësore, që e bën ofertën e OE Interlab SH.P.K te papërgjegjshme.

Po ashtu disa nga pajisjet e ofruara nga ana juaj nuk janë në përputhje me specifikimet e kërkuara në **Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme të dosjes së tenderit**, si ne vijim:

| Nr. | Aneksi 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME | Oferta e O.E Interlab SH.P.K | Koment |
|-----|--|------------------------------|--------------------------------|
| 28. | X-ray radiografi digital (poz.nr.28) 55cm – 85cm | 50cm – 72cm | Nuk e ploteson max. e lartesis |

| | | | |
|--------------|---|--|---------------------------------------|
| 18, 63,76 | Ultrazeri ne gjinekologji 3D/4D , Monitori 15", Hard disk size 500GB, Convex probe 1.0 – 7.0MHz, Linear probe 4.0 – 16.0MHz | Ultrazeri 3D Monitori 14.1" ≥ 128GB Convex probe 3MHz, Linear probe 7MHz | Nuk e posedon 4D |
| 47. | Aparat anestezionit me respirim mbrojtes te mushkerive I avancuar | Aparati i anestezionit nuk e posedon respirimin mbrojtes te mushkerive I avancuar | Nuk e ploteson pershkrimin e PM |
| 56. | Tavoline Gjinekologjike , Dimenz. 558 x 1877 mm | Dimenz. 600 x 1780 mm | Nuk e ploteson gjatesin |
| 57. | Tavoline gjinekologjike per lindje , Dimenz. 1898 x 898 mm | Dimenz. 1780 x 600 | Nuk e ploteson gjatesine dhe gjeresin |
| 59. | Fototerapi- nxemes , Monitor 12.1" | Monitori 10.1" | Nuk e ploteson |
| 61. | Inkubator transportues | Ne katalogun e ofruar i mungon specifikimi Teknik i pajisjes. | |
| 78. | Respiratore transportues | Ne katalogun e ofruar i mungon specifikimi Teknik i pajisjes. | |
| 97. | Hematologjik 3 diferencial 26 parameter | 24- parameter | |
| 98. | Hematologjik 5 diferencial 44- parameter, 80 test/h | 35- parameter, 60 test/h | Nuk e ploteson |
| 99. | Analizer bioikimik automatik | | |
| 101. | Analizator urine, Sample volume: 2.5ml | Sample volume: 5ml | Nuk e ploteson |
| 106. | Aparat hemostaze , | Ne katalogun e ofruar jane dy modele te pajisjeve qe nuk jane te nenvizuar | |
| 110. | Centrifuge , 5000 rpm, Max.RCF. 2850xg | 4500 rpm. 2490xg | Nuk e ploteson |

Kjo tregon qartë se vendimi për eliminimin e ofertës tuaj si oferte e papërgjegjshëm është marrë në përputhje të plotë me LPP-në.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit